

VENDIM
Nr. 159, datë 2.3.2016

PËR MIRATIMIN E LISTËS SË VENDEVE TË TRETA TË SIGURTA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 10, të ligjit nr. 121/2014, “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së vendeve të treta të sigurta, sipas shtojcës bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Kur zhvillimet në një ose më shumë vende mund të sjellin ndryshime në kushtet e atyre vendeve, ministri i Punëve të Brendshme, sipas parashikimeve të nenit 10, të ligjit nr. 121/2014, “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”, pas marrjes së mendimit zyrtar të Ministrisë së Punëve të Jashtme, propozon ndryshimin e kësaj liste.
3. Në përgatitjen e ndryshimeve në listën e vendeve të treta të sigurta mbahen parasysh të dhënat që merren nga institucionet e specializuara të Republikës së Shqipërisë për përfitimin e informacionit nga vendet e origjinës, listat e hartuara për qëllime të ngjashme nga shtete apo organizata ndërkombëtare, si dhe mendimi përkatës i UNHCR-së ose i organizatave ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.
4. Ministria e Punëve të Jashtme, në bazë të të dhënave që ka dhe vlerësimeve që bën, mund t'i rekomandojë në çdo kohë Ministrisë së Punëve të Brendshme ndryshim të listës bashkëlidhur këtij vendimi.
5. Vendimi nr. 1260, datë 23.12.2009, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së vendeve të treta të sigurta”, shfuqizohet.
6. Ngarkohet Ministria e Punëve të Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

SHTOJCA NR. 1
LISTA E VENDEVE TË TRETA TË SIGURTA

Vendet që përfshihen në listën e vendeve të treta të sigurta, paraqiten në vijim:

1. Andora
2. Australia
3. Austria
4. Belgjika
5. Bosnjë-Hercegovina
6. Bullgaria
7. Danimarka
8. Estonia
9. Finlanda
10. Franca
11. Greqia
12. Gjermania
13. Holanda
14. Hungaria
15. Irlanda
16. Islanda

17. Italia
18. Japonia
19. Kanadaja
20. Koreja e Jugut
21. Kosova
22. Kroacia
23. Letonia
24. Lituania
25. Luksemburgu
26. Mali i Zi
27. Malta
28. Mbretëria e Bashkuar
29. Norvegjia
30. Polonia
31. Portugalia
32. Qipro
33. Çekia
34. Maqedonia
35. Rumania
36. Serbia
37. Sllovakia
38. Sllovenia
39. Spanja
40. Suedia
41. Shtetet e Bashkuara të Amerikës
42. Turqia
43. Zelanda e Re
44. Zvicra